



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE



VLERËSIM I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

Maj 2023

Ora 10.00

Lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre

Udhëzime për nxënësin

Testi ka në total 60 pikë.

- 27 pikë për gjuhën shqipe;
- 21 pikë për matematikën;
- 12 pikë diturinë e natyrës.

Në pyetjet me zgjedhje qarkoni vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 1 orë e 30 minuta.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Pikë											
Pyetja	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
Pikë											
Pyetja	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33
Pikë											
Pyetja	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44
Pikë											
Pyetja	45	46	47	48	49	50	51	52			
Pikë											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

Gjuhë shqipe

Kush e solli pranverën

Një ditë të bukur pranvere, lulet po grindeshin midis tyre.

- Pranverën e solla unë! – thërriste trëndafili.
- Jo, jo!... E solla unë! - thoshte një zambak i verdhë.
- Pushoni! Pranverën e solla unë! – thoshte rëndë-rëndë qershia, që t'i vriste sytë me bardhësinë e fustanit që kishte veshur.

Vetëm manushaqja erëkëndshme nuk fliste fare. Qëndronte kokulur mes barit të njomë dhe i vinte turp nga ato që dëgjonte. Dësh të thoshte diçka, por ngurronte. Pse të lëvdohej se edhe ajo ishte nga lulet e para që çelnin, kur trokiste pranvera ...

Kaluan ditë e lulet, të zemëruara, pothuaj nuk flisnin fare më njëra-tjetrën. Këtë gjë e vuri re bleta e vogël.

- Ua! – u habit ajo, kur mori vesh përse ishin grindur. – Po për këtë gjë nuk flisni ju? Edhe unë, që jam e vogël, e di. Pranverën e sollët të gjitha së bashku. Vetëm më një lule ajo nuk vjen kurrë!

Kur dëgjuan këto fjalë, trëndafili u bë prush i kuq nga turpi, shpatorja u mavijos, një lule u bë aq e kuqe në fytyrë, sa i mbeti edhe emri lulëkuqe. Lulet e tjera heshtën gjatë, të penduara, sa një ditë, kur provuan të flisnin, nuk shqiptonin asnjë fjalë.

Kurse qershia, e cila ishte mburrur më tepër, hoqi fustanin e bardhë dhe na dhuroi e para aq shumë frute të ëmbla e të shijshme.

1. Kjo histori është një: 1 pikë
 A) legjendë.
 B) përrallë.
 C) histori fantastiko-shkencore.
 D) histori e jetës së përditshme.

2. Pse grindeshin lulet? 1 pikë
 A) Cila e solli e para pranverën.
 B) Cila kishte aromë më të mirë.
 C) Cila kishte më shumë ngjyra.
 D) Cila ishte më e bukura.

3. Nga fjalët e bletës lulet ndjenë: 1 pikë
 A) kënaqësi.
 B) zili.
 C) inat.
 D) turp.

4. Çfarë bënte manushaqja tek dëgjonte lulet që mburreshin? 1 pikë
 A) Përpiqej t'i bindte se pranverën e solli ajo.
 B) Fliste vetëm me njërën prej tyre.
 C) Qëndronte kokulur.
 D) Mburrej edhe ajo.

5. Bleta u mësoi luleve se: 1 pikë
 A) lulet nuk kanë rol në ardhjen e pranverës.
 B) pranvera nuk vjen me një lule.
 C) pranverën e solli trëndafili.
 D) pa bletë nuk ka jetë.

6. Çfarë i ndodhi lulëkuqes pasi dëgjoi fjalët e bletës? 1 pikë
 A) U mavijos.
 B) U zbardh e tëra.
 C) U bë prush nga turpi.
 D) U bë e kuqe në fytyrë.

7. Shprehja *t'i vriste sytë* në fjalinë: "*Pranverën e solla unë! – thoshte rëndë-rëndë qershia, që t'i vriste sytë me bardhësinë e fustanit që kishte veshur.*", ka kuptim të përafërt me: 1 pikë
 A) ishte shumë i bukur.
 B) ishte shumë i errët.
 C) ishte shumë i bardhë.
 D) të shkaktonte dhimbje.

8. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon një karakteristikë të qershisë? 1 pikë
 A) Inatçore.
 B) E zgjuar.
 C) Dredharake.
 D) Mendjemadhe.
9. Në fjalinë e dhënë, dalloni fjalët e autorit. *"Pranverën e solla unë!- thërriste trëndafili."* 1 pikë
10. Në çfarë vendi zhvillohet ngjarja? 1 pikë
11. Shkruani një cilësi të manushaqes që shfaqet në këtë pjesë. 1 pikë
12. Gjeni një titull tjetër për pjesën. 1 pikë
13. Cili është mesazhi i kësaj pjese? 1 pikë

Trëndafili

Një nga bimët zbukuruese më të kultivuara në botë, për shekuj me radhë, është trëndafili. Ai lulëzon për muaj të tërë, duke prodhuar lule të mëdha dhe me ngjyra të larmishme, si të kuqe, rozë, të verdha, të bardha apo dyngjyrëshe. Ka shumë lloje që nuk kanë aromë, por ka edhe të tjerë që kanë aromë të mrekullueshme. Mirëmbajtja e trëndafilave është aq e thjeshtë, sa është e mundur që gjithmonë t'i kesh në një vazo. Për këtë arsye, ato janë bimë që mund të përdoren për të dekoruar ballkone ose tarraca.

Bimët e njohura si trëndafila janë një seri shkurresh, zakonisht me gjemba. Ka rreth 100 specie, të cilat rriten në Azi, Amerikën e Veriut, Evropë dhe Afrikën Veriperëndimore, por shumica gjenden në kontinentin aziatik. Trëndafilat mund të rriten në lartësi prej 10 centimetra deri në 20 metra.

Shkurre trëndafili të egër janë ato që rriten natyrshëm. Ato priren të prodhojnë lule më të vogla dhe kanë tendencë të kenë shumë më tepër gjemba për të larguar grabitqarët.

Është e rëndësishme që trëndafilat të rriten në ambiente të hapura, sepse brenda shtëpisë nuk mund të rriten mirë, si rezultat i mungesës së dritës. Pavarësisht nëse do të jenë në tokë, ose në vazo, është e qartë se ata duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme për t'u rritur. Ata nuk e durojnë dot thatësinë. Për këtë arsye duhen ujitur mesatarisht tri herë në javë në verë, dhe dy herë në javë gjatë pranverës, vjeshtës dhe dimrit.

Trëndafili është bimë shumë mirënjohëse. Ai nuk ka nevojë për shumë kujdes, prandaj shihet aq shpesh në ballkonet e shtëpive.



14. Autori e shkroi këtë pjesë kryesisht: 1 pikë
 A) për ta bindur lexuesin të shkojë në kontinentin aziatik.
 B) për të na treguar se trëndafilat janë shumëngjyrësh.
 C) për të na dhënë informacion për trëndafilat.
 D) për të na udhëzuar si t'i mbjellim trëndafilat.
15. Në fjalinë: *"Pavarësisht nëse do të jenë në tokë, ose në një vazo, ata duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme për t'u rritur."* folja e nënvizuar është në: 1 pikë

 A) kohën e tashme.
 B) kohën e ardhme.
 C) kohën e pakryer.
 D) kohën e kryer të thjeshtë.

16. Fjala *një* në fjalinë “Një nga bimët zbukuruese më të kultivuara në botë, për shekuj me radhë, është trëndafili.” është: 1 pikë

 A) numëror.
 B) parafjalë.
 C) pjesëz.
 D) lidhëz.
17. Fjala *dyngjyreshe* është fjalë: 1 pikë

 A) e parme.
 B) e prejardhur.
 C) e përbërë.
 D) e përngjitur.
18. Formoni një fjali me mbiemrin *i trëndafiltë*. 1 pikë

19. Rishkruani fjalinë duke përdorur sinonimin për fjalën e nënvizuar: “Për këtë arsye, ato janë bimë që mund të përdoren për të dekoruar ballkone ose tarraca”. 1 pikë

 Sinonimi: _____
20. Krijoni një fjali, ku folja *lulëzoj* të vendoset në kohën e pakryer, veta e tretë, numri shumës. 1 pikë

21. Në fjalinë e mëposhtme gjeni ndajfoljen: 1 pikë
 “Shkurre trëndafili të egër janë ato që rriten natyrshëm.”

 Ndajfolja: _____
22. Ndërttoni një fjali pyetëse për këtë përgjigje: “Ka rreth 100 specie që rriten në Azi.” 1 pikë

23. Ndryshoni vendin e kryefjalës, pa prishur kuptimin e fjalisë: 1 pikë
 “Një nga bimët zbukuruese më të kultivuara në botë, është trëndafili.”

24. Shkruani një tekst përshkruues me temë: “Ardhja e pranverës”. 4 pikë

Ideja – 1 pikë	Organizimi – 1 pikë	Stili – 1 pikë	Saktësia gjuhësore – 1 pikë	Pikët

Matematikë

25. Qarkoni vlerën e shifrës së nënvizuar: 8 487 219.

1 pikë

- A) 40000
B) DHM
C) 4000
D) QM

26. Cila njësi matëse përdoret për gjatësinë?

1 pikë

- A) Kilogrami.
B) Metri.
C) Litri.
D) Grami.

27. Arlinda do të vendosë disa kuti me gjatësi 33 cm në një raft që është 99 cm i gjatë.
Sa kuti mund të vendosë Arlinda në raft?

1 pikë

Kryeni veprimin.

28. Gjeni: $\frac{4}{5}$ e 20

1 pikë

Kryeni veprimin.

29. Një grup nxënësish të klasës së pestë shkuan për një shëtitje dhe u kthyen në pikën e nisjes në orën 12:00.
Nëse shëtitja e tyre zgjati 1 orë e 30 minuta, në çfarë ore e filluan ata shëtitjen?

1 pikë

30. Një sallë provimesh ka 5 rreshta me karrige.
Çdo rresht ka 35 karrige. Sa karrige ka në sallën e provimeve?

1 pikë

Kryeni veprimin.

31. Plotësoni me numër dhjetor.

1 pikë

$$0,1 + \underline{\quad} = 0,9$$

32. Vendosni shenjën >; <; =

1 pikë

$$-3 \bigcirc 3$$

33. Numri 0,8 është i njëjtë me:


1 pikë

- A) tetë të qindtat.
B) një e teta.
C) tetë të dhjetat.
D) tetë.

34. Trekëndëshi ABC është kënddrejtë në B. Masa e $\hat{A} = 30^\circ$

1 pikë

Sa do të jetë masa e $\hat{C}$?



35. Gjeni vlerën e $\square$ në barazimin:

1 pikë

$$4 \times \square + 20 = 52 \quad \text{Kryeni veprimin.}$$

36. Perimetri i një drejtkëndëshi është 32 cm. Një prej brinjëve të tij është 7cm. Sa është brinja tjetër e drejtkëndëshit?

2 pikë

37. Në një magazinë janë 585 kg miell që do të shpërndahen në mënyrë të barabartë në 13 furra buke. Sa kg miell do të marrë një furrë buke?

2 pikë

38. Vendosni numrat e mëposhtëm në rendin rritës:

1 pikë

24, 16, 0, 13, -21

39. Babai bleu 32 fidanë agrumesh me nga 500 lekë secilin dhe disa fidanë ullinjsh me nga 700 lekë secilin, duke shpenzuar gjithsej 32800 lekë. Gjeni sa fidanë ullinjsh ka blerë babai?

3 pikë

40. Nxënësit e klasës së pestë bënë një studim mbi frutat e preferuara të disa nxënësve. Të dhënat i paraqitën në tabelën e dendurisë.

2 pikë

a) Paraqitni të dhënat e tabelës në diagram me shtylla.

Frutat	Denduria
Qersh	10
Dardhë	4
Mollë	2
Portokalle	6

b) Cili është fruti më i preferuar nga nxënësit? _____

Dituri Natyre

41. Cili nga objektet e mëposhtëm është i përbërë prej druri?

1 pikë



Objekti i përbërë prej druri është _____

42. Në figurë paraqitet lulja e radhiqes. Mënyra më e mirë e shpërndarjes së farave të kësaj luleje është nëpërmjet: 1 pikë


- A) ujit.
- B) erës.
- C) zogjve.
- D) kafshëve.



43. Plotësoni vendin bosh:

Magnetet e vendosur pranë njëri-tjetrit si në figurë do të _____.

1 pikë



44. Deveja jeton në zona:

1 pikë

- A) të nxehta e me lagështirë.
- B) të nxehta e të thata.
- C) të ftohta e me lagështirë.
- D) të ftohta e të thata.

45. Në qendër të sistemit diellor është:

1 pikë

- A) Jupiteri.
- B) Marsi.
- C) Toka.
- D) Dielli.

46. Në figurë jepet një tenxhere me ujë e vendosur në zjarr. Uji po vlon.

Përshkruani procesin që ndodh te kapaku i tenxheres.

1 pikë



47. Katër makina lodër u shtynë në një sipërfaqe me të njëjtën forcë. Grafiku tregon lëvizjen dhe kohën që iu duhet makinave për të lëvizur. Cila nga makinat ka lëvizur më shpejt?



1 pikë

- A) Makina 2 ka lëvizur më shpejt se makina 1.
- B) Makina 1 ka lëvizur më shpejt nga të gjitha.
- C) Makina 3 ka lëvizur më shpejt se makina 4.
- D) Makina 3 ka lëvizur më shpejt nga të gjitha.

48. Stinët e vitit formohen si pasojë e:

1 pikë

- A) rrotullimit të Tokës rreth vetes.
- B) rrotullimit të Hënës rreth Tokës.
- C) rrotullimit të Hënës rreth Diellit.
- D) rrotullimit të Tokës rreth Diellit.

49. Si përhapet tingulli për të ardhur deri në veshin e njeriut?

1 pikë

- A) Tingulli vjen te veshi i njeriut nëpërmjet disa valëve që duken.
- B) Tingulli vjen te veshi i njeriut nëpërmjet disa valëve të padukshme që shkaktohen nga dridhja.
- C) Tingulli vjen te veshi i njeriut nëpërmjet disa dritave që ndizen dhe fiken kaq shpejt saqë nuk duken.
- D) Tingulli vjen te veshi i njeriut nëpërmjet një serie goditjesh që prodhohen nga diçka që shkakton zhurmë.

50. Në figurë jepen elementet e një qarku të thjeshtë elektrik. Elementi me numrin 2 është:

1 pikë

- A) bateria.
- B) teli lidhës.
- C) llamba.
- D) çelësi.




51. Cili është funksioni kryesor i rrënjëve?

1 pikë

- A) Riprodhimi.
- B) Prodhimi i ushqimit.
- C) Thithja e ujit dhe mineraleve.
- D) Transportimi i ujit në gjethe dhe lule.

52. Në figurën e mëposhtme tregohet një pemë dhe pozicioni i Diellit gjatë ditës. Në cilën orë të ditës pema do të lëshojë hijen më të shkurtër?

1 pikë



Pema do të lëshojë hijen më të shkurtër në orën _____